



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 12

Prishtinë, më 24.04.2015 ora: 12:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

i mbledhjes së komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaili, Shqipe Pantina, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Alma Lama dhe Jelena Bontic.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Në mbledhje morën pjesë: Adnan Merovci - Kryetari i KPM-së, dhe Naile Selimaj- kryeshefe ekzekutive e KPM-së, si dhe përfaqësuesi nga OSCE.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2014;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;

Procesverbalet e dt. 08 prill dhe 17 prill 2015, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2014;

Adnan Merovci - në bazë të obligimit ligjor, sot jemi këtu për të prezantuar raportin vjetor 2014. Raporti është standard dhe në këtë fazë të raportimit kisha me u ndal te disa pika që janë formë e e punës së KPM-së, e këto pika kanë të bëjnë me strategjinë për digjitalizimin në Kosovë. KPM-ja si autore e strategjisë për digjitalizim e ka përfunduar punën dhe strategjinë e ka dorëzuar në Qeveri mbi bazë të së cilës duhet të hartohet P/ligji për digjitalizim, në mënyrë që pastaj të miratohet nga Kuvendi i Kosovës, sa i përket P/ligjit nuk ka nevojë për konsulencë, sepse ligji do të jetë vetëm si pikënisje e fillimit të digjitalizimit në Kosovë që nënkupton se është rrjedhojë e strategjisë për digjitalizimin në Kosovë.

Digjitalizimi duhet të kuptohet si një operator i ri për transmetuesit që bëhet me transparencë, në baza tenderuese e që deri më tani me sistemin e transmetimit analog janë zgjedh me konkurse të ndryshme. P/ ligji i nxjerr nga strategjia është i natyrës teknike, pasi ai ka të bëjë me procedurën dhe shpalljen e tenderit për operatorët e rinj.

P/ligji i ka dy shmanjie: përfshirja e TV-regjionale në frekuenca nacionale teknikisht është e pamundur për arsye të numrit të limituar të frekuencave.

Xhevahire Izmaku – lidhur me raportin, ajo tha, se është bërë një punë serioze, ndërsa për çështjet buxhetore, me shkurtime të cilat janë bërë këtë vit është dëmtuar gjithashtu KPM-ja, ne si deputet, me rishikimin e buxhetit për vitin 2015 do të llobojmë për një rritje të buxhetit për KPM si dhe për shtimin e numrit të punëtorëve, ajo pastaj pyeti:

- që pas digjitalizimit a do të ketë dyndje të kërkesave për licenca nga operatorët e rinj;
- a është përfunduar miratimi i rregullores për operatorët kabllor si dhe
- a i keni urdhëruar operatorët kabllorë që të mos veprojnë;
- si bëhet kategorizimi i subjekteve transmetuese sidomos tek radiot nacionale të cilat gjatë transmetimit kanë ndërprerje dhe ndërhyrje
- nëse lirohet, shfrytëzimi i majës së Goleshit edhe pse e dimë që kjo është çështje politike, a i ndihmon një fuqizimi më kualitativ të TV-ve, dhe çka përfitojmë po qese lirohet maja e Goleshit.
- Sa i përket Bordit të Ankesave për Media, a ka nevojë të ekzistojë si organ i shkallës së dytë të KPM-së kur e dimë që vetëm 4 vendime i ka shqyrtuar brenda një viti.

Shqipe Pantina – meqë edhe nga raportet e viteve të kaluara është ngritur si çështje e njëjtë çështja e TV nacionale që vazhdimisht i shkelin rregullat e komunikimeve komerciale, reklamave, duke filluar nga RTK-ja, cilat janë masat që KPM-ja si rregullator i ka ndërmarrë ndaj kësaj çështje që tani pothuajse është bërë fenomen, a duhet të ndërrohet rregullorja apo çka duhet të ndërmerr KPM-ja që ky fenomen mos të përsëritet.

- Cilat janë planet që KPM-ja duhet t'i ndërmerr lidhur me çështjen e mbulueshmërisë me frekuenca transmetuese kur dihet që vetëm 62% të territorit të Kosovës ka mbulueshmëri me frekuencat ekzistuese;
- a ka KPM-ja ndonjë plan konkret për çështjet e interferencave të radiove;
- lidhur me metodologjinë që KPM-ja e përdorë gjatë fushatës në kontekst të hapësirave si kohore dhe asaj të përmbajtjes cila është metodologjia që duhet të zbatohet?

Zafir Berisha – pyeti lidhur me marrjen dhe shqiptimin e masave të buta ndaj radiove të cilat i shkelin rregullat sidomos atyre radiove kur ju merret licenca; Çfarë kushte duhet t'i plotësojë për rikthimin e licencës apo duhet që përsëri të aplikoj?

Pal Lekaj – strategjia në të vërtetë përcakton fushën e digjitalizimit, por, ai tha, se nuk mendon që ligji është dhe duhet të jetë i natyrës teknike sepse për arsye se ligji ka rolin sanksionues. Sa i përket monitorimit është vështirë të monitorohen të gjitha TV, përveç tri TV nacionale sepse nuk ka hapësirë vepruese të monitorimit. Ndërsa, është e domosdoshme që të gjitha TV dhe radiot duhet të monitorohen strikt sepse qytetarët po ballafaqohen me dukuri negative.

Kujtim Paçaku – pyeti sa ankesa ka pasur KPM-ja lidhur me shkeljen e kodit të sjelljes dhe a kanë qenë ato ankesa nga qytetarët, çfarë përmbajtje kanë pasur dhe a ka pasur KPM-ja kërkesa për një TV multi-etnike.

Zenun Pajaziti – pyeti a mendoni se është koha të rishikohet roli i KPM-së në dhënien e hapësirave për frekuenca, si e shihni rolin e operatorëve kabllor në këtë proces, si konkurrues, ndërlihdës, a është proces i vonuar, apo mund të dëmtohet dikush.

Adnan Merovci - ju përgjigj pyetjeve të deputetëve:

Tani fjala frekuencë do të zëvendësohet me fjalën MUX me digjitalizim, do të jenë dy frekuenca për 38 kanale, ndërsa lidhur me atë se a do të mundet që ti absorbojë ky kapacitet pretendimet tani me një medium të ri transmetues do të kemi një treg plural. Sa i përket operatorëve kabllor ilegal, tani është një numër shumë i vogël sepse të gjithë kanë aplikuar dhe janë legalizuar.

Tek kategorizimi i subjekteve transmetuese këto janë çështje relative, që të gjitha nuk janë nacionale në kuptimin e mbulueshmërisë, sepse janë të kategorizuara në nacionale, regjionale dhe lokale varësisht nga kërkesa e tyre për licencë.

Kur është fjala për mbulueshmërinë kjo duhet të kuptohet si mbulueshmëri e popullatës dhe jo e territorit, por që gjithashtu kjo është relative sepse është punë shtesë që TV-te dhe radiot duhet ta bëjnë për mbulueshmëri.

Ndërsa sa i përket antenës së Goleshit është një çështje kryciale sepse më një antenë për afërsisht mbulohet i gjithë territori i Kosovës.

Me digjitalizimin janë paraparë pesë pika transmetuese dhe vetë digjitalizimi do t'i rregullojë tejkalimet e TV nacionale sepse shikueshmëria ka me qenë mbi bazat e përmbajtjes së transmetuesit.

Në përfundim të debatit, z. Adnan Merovci, ngriti çështjen e vështirësive të mëdha financiare me të cilat po ballafaqohet Komisioni i mediave duke paraqitur kërkesën që në kuadër të rishqyrtimit të buxhetit të Kosovës, të ndërmerret diçka për përmirësimin e kësaj gjendjeje. Gjendja e rëndë financiare u konfirmua, por u tha se janë bërë shkurtime buxhetore edhe për institucione të tjera.

Konstatim: Komisioni pas përmbylljes së debatit, me shumicë votash dhe një abstenim të znj. Shqipe Pantina, miratoi Raportin dhe nxori rekomandimin si në vijim:

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 67 dhe 72, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 24.04.2015, shqyrtoi Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2014, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2014.
2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Arsyetimi

Në bazë të nenit 3, paragrafi 2, pika 8, të Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media, KPM-ja ia paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës deri me 31 mars të vitit vijues një raport vjetor, duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave dhe të ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit si dhe objektivat për vitin e ardhshëm. Raporti vjetor duhet të bëhet publik pas miratimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 24.04.2015, shqyrtoi Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, dhe vlerësoi se i njëjti përmbush obligimet ligjore për raportim dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

4. Të ndryshme

Zenun Pajaziti – i njoftoi anëtarët e komisionit, për vizitën e tij në Slloveni, i cili ishte i ftuar në cilësinë e Kryetarit të komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media.

- Komisioni konfirmoi ftesën për punëtori nga Asociacioni i Komunave të Kosovës me qëllim të diskutimit dhe përgatitjes për iniciimin e procedurave për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, e cila punëtori do të mbahet me 10-12 maj 2015, në Durrës – Shqipëri.
- Komisioni kërkoi nga zyra koordinuese e komisionit që t'i dërgohet një shkresë GAP, INDEP, OSCE, KDI, që komisioni e mirëpret ofrimin e ekspertizës për plotësim-ndryshimin e ligjit për RTK nga këto organizata.

Shqipe Pantina – propozoi që të fillohet me monitorimin e ligjeve, sipas planit të punës së Komisionit.

Ky propozim u miratua nga Komisioni.

Mbledhja përfundoi në ora:15:15

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit
Zenun Pajaziti**
